



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 68, datë 19.12.2019

PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS
KANALIZIME VORË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 39**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.12.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Vorë sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Vëren se:

Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Vorë" (**UK Vorë**) me shkresë nr. 577 prot. datë 26.06.2018, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe Vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Vorë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me Vendimin 05 datë 01.02.2019 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Vorë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63 dt. 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura."

2. Ujësjetllës Kanalizime Vorë në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU me shkresë nr. 577 prot. datë 26.06.2018 *“Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”* propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tre kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria sipas Kategorisë së Konsumatorëve

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara	Diferenca
a. Për shërbimin e furnizimit me ujë	(lekë/m³)	(lekë/m³)	(lekë/m³)
1. Klientë familjar	65	80	+15
2. Klientë publik	140	150	+10
3. Klientë privat	155	190	+35
4. Furra buke	95	-	-
5. Klientë të veçantë	170	-	-
b. Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura	(lekë/m³)	(lekë/m³)	(lekë/m³)
1. Klientë familjar	11	18	+7
2. Klientë publik	30	50	+20
3. Klientë privat	35	50	+15
4. Furra buke	13	-	-
5. Klientë të veçantë	40	-	-
c. Tarifë fikse shërbimi			
1. Klientë familjar	200	250	+50
2. Klientë publik	200	250	+50
3. Klientë privat	200	250	+50
4. Furra buke	200	250	+50
5. Klientë të veçantë	200	250	+50

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2018, referuar tarifave të reja të propozuara shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2018, 2019 dhe Objektivat për Vitin 2020 jepen në tabelën e mëposhtme:

Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Shoqërisë

Treguesit e Performancës	Njësia	Treguesit e Performancës sipas Shoqërisë		
		Viti 2018 (i mbyllur)	Viti 2019 (i pritshëm)	Objektivat Viti 2020
Uji Pa të Ardhura	%	70.4	67.2	66
Mbulimi i Kostove O&M	%	88	84.4	91.3
Mbulimi i Kostove Totale	%	85	82	89
Niveli i Matjes	%	65	74	75
Vazhdimësia e FU	orë/ditë	5	6	8
Efikasiteti i Stafit (staf/1000/lidhje)	nr.	8.2	10.8	10.1
Mbulimi me Ujë	%	54.4	55.5	56.7
Mbulimi me KUN	%	53.2	54.2	55.7
Norma e Arkëtimit Korrente	%	79	80	83
Norma Arkëtimit e Përgjithshme	%	92	96	96

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave duke dhënë argumentet e mëposhtme:
- Pas riorganizimit të shoqërisë aplikon për ndryshimin e nivelit tarifor në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",
 - Shoqëria nuk arrin të mbulojë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes dhe nëpërmjet nivelit tarifor të propozuar synon përmirësim të tij me rreth 3% krahasuar me vitin e mbyllur 2018.
 - Shoqëria nuk ka një plan biznesi të mirëstrukturuar, por operon nëpërmjet një plani financiar për periudhën 2017-2020. Nisur nga analiza kosto - përfitim e rezultateve financiare 2017 (pjesërisht) dhe 2018 si dhe nevojës për kryerjen e investimeve afatgjata, UK Vorë ka kërkuar rishikim të strukturës së tarifave për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, me qëllim arritjen e objektivave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
 - Konstatohet se për vitin 2018 shoqëria ka një nivel të lartë të Ujit Pa të Ardhura 70.4%. UK Vorë ka nivel të ulët të mbulimi me shërbimet e furnizimit me ujë (54.4%) dhe atë të KUN (53.2%) dhe synimi është përmirësimi i nivelit të këtyre treguesve.
 - Nëpërmjet një plan veprimi për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura shoqëria synon përmirësimin e normës së arkëtitimit korrente por dhe atë të përgjithëshme me synimin rritjen e likuiditeteve të shoqërisë.
5. ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin nr.42, ka kërkuar nga UK Vorë informacion shtesë si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.
6. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar (**ligji nr. 9121**), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregimit;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e Konsumatorëve" të ndryshuar (**ligji nr. 9902**);
 - d) Orientimin drejt Mbulimit të kostove O&M pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove.
 - e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **përballueshmërinë**, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përballueshme.
 - f) Tarifatat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

- g) Propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, kjo referuar analizës tekniko ekonomike si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara në aplikimin paraardhës.

7. ERRU, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- a) Shoqëria duhet të hartojë plan biznesin 5 vjeçar si shoqëri e re e krijuar në kuadër të zbatimit të Reformës Territoriale sipas VKM nr. 63.
- b) Saktësia e informacionit është pikënisje për një analizë dhe gjykim të drejtë nga ERRU, prandaj dhe UK Vorë në aplikimin e radhës duhet të jetë korrekte me shifrat dhe informacionin e vënë në dispozicion.
- c) Detyrimisht shoqëria duhet të mbajë kostot të ndara për secilin shërbim që ofron.
- d) Të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë nën zërat e tij, duke angazhuar stafin që çdo komponent që përbën këtë bilanc të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasinë e ujit që nuk maten, mbi sasinë e ujit që falen etj.
- e) Të hartojë planin e masave për reduktimin e humbjeve të ujit.
- f) Të eliminojë humbjet e ujit që shkaktohen nga rrjedhjet në linjat e transmetimit (nga stacioni i pompave deri në depo) pasi zënë dhe përqindjen më të lartë të humbjeve totale.
- g) Të marrë masa për eliminimin e humbjeve të ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes.
- h) Të evidentojë në terren numrin e klientëve.
- i) Të riparojë në kohë defektet e shumta në rrjet si dhe të vlerësojë sasinë e ujit që humbet para dhe gjatë riparimit.
- j) Të hartojë inventarin e aseteve me informacionin për datat kur janë instaluar dhe të gjitha të dhënat e tyre (materialin, dimensionet, gjatësitë etj.)

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifën e propozuar nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 42, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura*" si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifën e propozuar sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar si dhe përballeshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 "Për mbrojtjen e Konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr.8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vorë si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas Vendimit në Zonën e Shërbimit
Tarifë Volumetrike për Furnizimin me Ujë	Lek/m³
Konsumatorë Familjarë	65
Konsumatorë Publik	140
Konsumatorë Privat	155

Tarifë Volumetrike për KUN	Lek/m³
Konsumatorë Familjarë	15
Konsumatorë Publik	30
Konsumatorë Privat	35
Tarifë Fikse	Lek/muaj/lidhje
Konsumatorë Familjarë	200
Konsumatorë Publik	200
Konsumatorë Privat	200

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës të vitit 2020 për Shoqërinë UK Vorë të jenë:

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Niveli i Objektivit për Vitin 2020 të Përcaktuar nga ERRU
Mbulimi i Kostove O&M	%	100
Uji pa të ardhura	%	66
Niveli i Matjes	%	80
Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	8
Efiçenca e Stafit	staf/1000 lidhje	8.1
Mbulimi me Ujë	%	57
Mbulimi me KUN	%	55.7
Norma e Arkëtimit Korente	%	83
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	96

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vorë sh. a do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.
4. Lidhjen e kontratës me UK Vorë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr. 8102.
5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.02.2020 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani